



RAMAZANI IM


Ilustrimet:
Raisa Dibra

Transkriptimet:
Albiona Olluri


Transkriptimet janë shkëputje prej
ligjëratave të hoxhës Lulzim Perçuku

LEXO DHE NGJYROS

Allahu thotë: "**O ju që keni besuar! Ju është bërë obligim agjërimi ashtu siç u ishte bërë atyre para jush, në mënyrë që të arrini devotshmërinë.**" Bekare 183.



Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Ju erdhi muaji i Ramazanit i cili është muaj i bereqetshëm!”**




Ramazani duhet të agjërohet për hir të Allahut, me besim e bindje të plotë dhe me shpresë në shpërblimin e Tij.



Allahu thotë: **“Unë shpërblej për agjërimin.”**


Përgëzoje veten me mirësi ngase Zoti yt është Bujari dhe shpërblimi që ta jep Ai për agjërimin është vërtet shumë i madh!




Një mirësi e madhe ndaj nesh është arritja e
Ramazanit duke qenë në Islam.



Ardhja e muajit të Ramazanit
duhet të ketë pozitë të veçantë në
shpirtin dhe zemrën e besimtarit.




Muslimani duhet ta presë Ramazanin në mënyrën më të mirë, me sinqeritet, dhe duke ia dhënë të drejtën që meriton.




Muaji i Ramazanit është një rast i mirë për
njeriun të kthehet tek Allahu me pendim.


Secili prej nesh ka nevojë të madhe që
bashkë me agjërimin edhe të pendohet (të
bëjë teube).




Agjëruesi duhet ta ruajë agjërimin nga gjërat e shumta të cilat e njollosin atë dhe ia pakësojnë shpërblimin (siç janë: ndalesat, mëkatet, fjalët e këqija, fyerjet, punët e këqija, lëndimi ndaj njerëzve, përgojimi, gënjeshtra etj.), ose që e zhvlerësojnë atë.




Hisja e devotshmërisë të cilën e arrin
përmes agjërimit, është për aq sa arrin të
ruash agjërimin tënd.



Muslimani e ka obligim që gjatë Ramazanit vazhdimisht t'i kushtojë kujdes bindjes ndaj Allahut dhe të dijë se Ai e mbikëqyrë.




Sa mirë është t'ia vësh qëllim vetes që gjatë këtij Ramazani të përpiqesh për përqendrim të lartë gjatë faljes së namazit!






Me agjërim, njeriu arrin të thyejë nefsin e tij, të kundërshtojë epshin e dëshirat, të pastrojë zemrën, të dëlirë shpirtin dhe të realizojë durimin, përruljen ndaj Allahut dhe ndjesinë se është nën mbikëqyrjen e Tij.



Agjëruesi i cili e ka shpërblimin më të madh
është ai që më së shumti e përmend Allahun
gjatë agjërimit të tij. I tilli arrin shkallë të lartë
në Xhennet dhe shpërblim të madh.



Ramazani është muaji i durimit. Allahu e
ka ligjësuar agjërimin për shumë dobi.
E prej tyre është stërvitja e shpirtit në
arritjen e durimit.



اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ

“O Allah, kërkoh nga Ti falje të
mëkateve dhe shpëtim!”






رَبَّنَا آتِنَا فِي الدُّنْيَا حَسَنَةً وَفِي الْآخِرَةِ حَسَنَةً وَقِنَا عَذَابَ النَّارِ


“O Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit (të xhehenemit)!”




Kur je duke ngrënë syfyr, kujtoja vetes
se me këtë je duke bërë një adhurim.



Agjërimi i Ramazanit është mundësi e madhe për njeriun të përmirësohet, qoftë në raport me Allahun apo në raport me njerëzit.



Për çdo të mirë që bën në Ramazan,
shpërblimi është shumë më i madh
sesa jashtë tij.




E gjithë dita e agjërimit është ditë e lutjeve.
Agjëruesi është prej atyre të cilëve Allahu
nuk ua kthen mbrapsht lutjet.



Njeriu në Ramazan arrin të edukojë
karakterin e tij. Nuk është synimi i
agjërimit vetëm mosngrënia e mospirja.
Por, edhe përmirësimi i sjelljes dhe i fjalëve.




Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë
**"Kush falet me imamin derisa të përfundojë
namazin, i shkruhet sikur të falet tërë natën."**



Shikoje agjërimin me shikimin e respektit,
madhërimin dhe dashurisë, e jo ta shohësh
si diçka të rëndë.



Umreja në Ramazan ka shpërblim të madh.
Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë:
"Umreja në Ramazan është sikur të bësh haxh."




Veprat më të mira në dhjetë netëshin e fundit:

-Itikafi.

-Namazi i natës.


-Leximi i Kuranit.

-Bërja e lutjeve.




اللَّهُمَّ إِنَّكَ عَفُوفٌ تُحِبُّ الْعَفْوَ فَاعْفُ عَنِّي

"O Allah! Ti je falës, e do faljen, andaj më fal
mua!"



Besimtari i mirë prej muajit të
Ramazanit merr mësimet e
udhëzime të mëdha, të cilat i vë në
praktikë gjatë gjithë jetës së tij.



Allahu e ka bërë obligim zekatul fitrin si pastrim për agjëruesin për fjalët e ulëta, lëshimet, gabimet apo mëkatet (e bëra gjatë Ramazanit), dhe ushqim për të varfrit.



Prej zakoneve të mira të muslimanëve është blerja e dhuratave për fëmijët për festën e Bajramit, që ata të gëzohen.



